



Progres i rekomandimeve të Këshillit të Investimeve

2015-2021


Këshilli i Investimeve (2015 - 2021)

25
MBLEDHJE

29
REKOMANDIME
2021

274
REKOMANDIME
PRILL 2015-
DHJETOR 2021

Nr i rekomandimeve sipas temës 2015-2021



Këshilli i Investimeve (2015 - 2021)


Rekomandimet në nivel institucional zënë peshën më të lartë mbi totalin 40%,

ku theksi vendoset kryesisht në

- bashkëpunimin ndërinstytucional
- ngritjen e kapaciteteve të strukturave operacionale
- qëndrueshmërinë e institucioneve
- rritjen e standardit dhe cilësisë së shërbimeve

REKOMANDIME SIPAS KATEGORISË


Strategjike Ligjore Institucionale Transparencë Politika Ndërgjegjësim



24% e total rekomandimeve të KI, adresojnë ndërhyrje në drejtim të dy sektorëve kryesorë si Turizmi dhe Bujqësia përfshirë Agropërpunimin duke synuar:


- Rritje të nivelit të formalizimit të sektorëve
- Incentiva për forcimin e sektorëve
- Ndërhyrje ligjore që do lehtësonin bizneset e këtyre sektorëve

REKOMANDIME SIPAS SEKTORIT



Ecure pozitive në përmbushje të rekomandimeve të KI (Prill 2015 - Dhjetor 2021)


Aktualisht, 40.5% e rekomandimeve totale janë të plotësuara, ndër të cilat gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021 evidentohet progres pozitiv në 33 rekomandime: 20 të zbatuara* dhe 13 në proces zbatimi.



■ Implementuar ■ Në Proçes ■ Jo implementuar

*Plotësisht (80-100%) ose pjesërisht (50-70%)

Ecure pozitive evidentuar gjatë vitit 2021



Ecure pozitive në përmbushje të rekomandimeve të KI (Prill 2015 - Dhjetor 2021)

Përmirësimi i Aksesit në Fonde për NMVM-të

Subvencionimi i naftës për fermerët si një instrument për të inkurajuar formalizimin e fermerëve dhe mbështetjen e investimeve të fermerëve - është miratuar në Janar 2021 dhe filluar zbatimin me 20,600 përfitues nga kjo skemë.

Suport Financiar për Start-Up përmes:

- Planit buxhetor afatmesëm (PBA) të AIDA 2022 ku janë parshikuar 10 mln ALL në formë granti për startup-et.

Mbështetje e targetuar për procesin e ndërkombëtarizimit të ndërmarrjeve

- AIDA menaxhon, në rolin e partnerit kryesor Rrjetin European të Ndërmarrjeve për Shqipërinë (EEN-Albania) përmes të cilit janë asistuar dhe nënshkruar deri tani 18 kontrata biznesi ndërmjet kompanive shqiptare dhe atyre të huaja.

Thjeshtimi dhe koordinimi më i mirë i informacionit mbi projektet /programet në mbështetje të NMVM-ve

-Ndërtuar një platformë e unifikuar me informacion të centralizuar mbi të gjitha skemat e financimit për NMVM-të, të ofruara nga donatorët dhe qeveria aida-smefinance.gov.al.

Ecure pozitive në përmbushje të rekomandimeve të KI (Prill 2015 - Dhjetor 2021)

Aksesi në TIK dhe Tregtia Elektronike për NMVM-të

Mbështetja e tregtisë elektronike përmes konsiderimit të formave alternative të kleringut për transfertat lokale në Euro, me qëllim uljen e kostove të larta të ngarkuara nga rrjeti korrespondent bankar –

BSH konfirmon se mbas përfundimit të studimit të fizibilitetit dhe prokurimit të sistemi të pagesave për shlyerjen në euro, tashmë janë në fazë testimi të tij për ta bërë sa më shpejt operacional.

Nxitja e tregtisë elektronike – si një model potencial i ofrimit të shërbimeve/produkteve në mënyrë të qëndrueshme

- Përfunduar studimi "Diagnostikimi i tregtisë elektronike në Shqipëri duke shfrytëzuar dixhitalizimin" përmes bashkëpunimit MFE-Banka Botërore.

- Hartuar një plan veprimi specifik për periudhën 2021-2024 me afate konkrete

- Ngritur grupi teknik i punës "Lidhjet/aktivitetet dixhitale" me pjesëmarrjen e ekspertëve të BB, MFE dhe MIE.

Saktësimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore kombëtare referuar nivelit të përdorimit dhe aksesueshmërisë në TIK nga bizneset

- Ndërmarrë një studim që ofroi të dhëna mbi përdorimin e TIK nga NMVM-të në Shqipëri dhe modele nga vendet e zhvilluara dhe rajoni që mund të konsiderohen për zbatim.

Prioritizimi i digjitalizimit dhe përshpejtimi i mbulimit kombëtar me brez të gjerë

- Studim fizibiliteti mbështetur nga WBIF dhe MIE, detajoi rajonet bazuar në përqendrimin e NMVM-ve dhe zonat prioritare për shtrirjen e brezit të gjerë.

- Një buxhet specifik u miratua nga MFE për të përshpejtuar procesin e mbulimit me brez të gjerë.

Ecure pozitive në përmbushje të rekomandimeve të KI (Prill 2015 - Dhjetor 2021)

Forcimi i bashkëpunimit Bashki Biznes:

Zbatimi i detyrimit ligjor sipas nenit 25 paragrafi ç) të ligjit "Për financat e vetëqeverisjes vendore" *për ndarjen e 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për njësitë e vetëqeverisjes vendore.*

Përmirësimi i transparencës së Bashkive përmes:

- Publikimit të rregullt të VKB-ve në website dhe në Vendime.AL
- Publikimi i PPV/ Strategjive të Zhvillimit Territorial
- Publikime të konsultimeve/ linqe për dërgim komentesh nga bizneset - qytetarët/ publikimin e datave të konsultimeve

Lehtësimi i marrjes së informacionit përmes një seksioni të dedikuar mbi procedurat e ankimit administrativ në njësitë e vetëqeverisjes vendore (52 nga Bashkitë i kanë regjistrat online tashmë).

Forcimi i kapaciteteve të Bashkive mbi përgatitjen cilësore të raportimeve financiare në mënyrë periodike:

- Asistuar 35+ bashki për implementimin e formateve miqësore të raportimit
- 40 bashki janë trajnuar dhe ofruar asistencë teknike për përdorimin e treguesve të performancës në raportimet e tyre financiare

Prioritete për ndërhyrje bazuar në rekomandimet e papërmbyshura

Janë aktualisht **122** rekomandime të paplotësuara ku ndër më kryesoret përmendim:

- *Përgatitja dhe miratimi i një Strategjie të mirëfilltë kundër ekonomisë informale*
- *Stabilizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor fiskal*
 - *Dixhitalizimi i regjistrave të disa institucioneve kyçe (si ASHK) që do lehtësonte më tej barrën administrative*
- *Forcimi i bashkëpunimit mes inspektorateve dhe ndërmarrja e inspektimeve të përbashkëta*

Rekomandime të paplotësuara sipas temës në %

